

## KLSH PËR VLERËSIMIN E CILËSISË ARTISTIKE.

nga Pjetër BELESHI – Auditues i lartë,

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 05 maj 2014



Vlerësimi i cilësisë artistike të veprave të artit dhe kulturore është një proces i vështirë që kërkon njohuri të mjaftueshme profesionale për çdo gjini të artit dhe kulturës. Në këtë shkrim nuk marrim përsipër një gjë të tillë pasi kjo përgjegjësi u takon artistëve të cilët i krijojnë ato dhe kanë të lidhur me këto veprimtari jetën e tyre artistike, profesionale dhe ekonomike. Në këtë shkrim duam të informojmë komunitetin e artistëve për abuzimet që bëhen në emër të cilësisë artistike nga ata që nuk janë

krijuesit e vërtetë të kësaj cilësie.

Në auditimet e kryera nga KLSH në disa institucione publike qendrore të artit dhe të kulturës, për administrimin e fondeve publike që buxheti i shtetit ka vënë në dispozicion të tyre, ka konstatuar parregullsi të theksuara që lidhen me moszbatimin apo zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë financiare të tyre. Në shumë raste këto parregullsi kanë qar në pasoja të dëmshme për fondet publike dhe kanë bërë që persona të veçantë nga administrata të përfitojnë shuma të konsiderueshme në emër të vlerësimit të cilësisë artistike.

Për të kuptuar më mirë se çfarë ndodh në këto restitucione duhet të sqarojmë se çfarë kërkon ligji për këtë qëllim, ç’duhet të bëjnë dhe si veprojnë institucionet e Artit dhe Kulturës për vlerësimin dhe shpërblimin cilësisë artistike dhe cilat janë pasojat për nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e krijimtarisë artistike nga moszbatimi e dispozitave ligjore.

Në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, është përcaktuar se, institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës kanë si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së tyre, nxitjen e zhvillimin e artit, si krijimtari shpirtërore, ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, eksperimentimin e formave të reja të

shprehjes skenike, realizimin e veprave artistike, shkëmbimet teatrore ndërkombëtare etj. Në këto institucione përfshihen; Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operës dhe Ansambli Popullor, Qendra kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave, Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës, Galeria Kombëtare e Arteve, Cirku Kombëtar dhe Teatri Kombëtar i Komedisë. Këto institucione kanë organet e tyre drejtuese dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre mbi bazën e statutit, të rregulloreve të brendshme të funksionimit dhe të dispozitave të ligjit për artin dhe kulturën.

Pa mohuar punën e këtyre institucioneve për sa i përket realizimit të repertorit artistik vjetor dhe të projekteve artistike në përputhje me politikën e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, KLSH ka vërejtur se Bordet Artistike të tyre si organe kolegjiale, nuk i kanë kryer si duhet detyrat në përmbushje të kompetencave që ju ka dhënë ligji. Këto Borde ***nuk kanë përcaktuar dhe miratuar kriteret dhe masën e shpërblimit të cilësisë artistike*** për çdo vepër që do të realizohet, në përputhje me germën “ç” të nenit 11, “Kompetencat e bordit artistik”, të ligjit për artin dhe kulturën, ku përcaktohen detyrat e bordeve, e për rrjedhojë vlerësimet e tyre për cilësinë artistike të veprave të realizuar kanë qenë subjektive dhe nuk kanë shërbyer për nxitje dhe zhvillimin e artit dhe kulturës në përgjithësi .

Fakti që shpërblimi i cilësisë artistike nga këto borde është përcaktuar përpara se të shfaqet para publikut produkti artistik apo kulturor, apo fakti që bordet artistike nuk kanë përcaktuar asnjë kriter të matshëm e të kontrollueshëm për vlerësimin e cilësisë artistike tregon për subjektivizmin që e karakterizon të gjithë procesin e vlerësimit. Po kështu fakti që administrata e këtyre institucioneve ka përfituar shpërblime të konsiderueshme, me pretendimin se ka dhënë kontribut për realizimin e veprave artistike tregon për abuzime në përdorimin e fondeve që shteti ka parashikuar për mbështetjen dhe zhvillimin e krijimtarisë artistike.

Institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës deri në vitin 2009, për shpërblimin e cilësisë artistike kanë zbatuar kriteret e përcaktuara në VKM nr. 309, datë 21.06.1993 “Për shpërblimin e cilësisë artistike në letërsi, artin figurativ, muzikor, kinematografik, ekzekutiv, interpretativ, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projekte kulturore” dhe Udhëzimin e Ministrisë nr. 1, datë 15.02.1994, të nxjerrë për zbatimin e këtij vendimi. Në këto dispozita në mënyrë të detajuar, ishin përcaktuar kriteret të matshme për vlerësimin e cilësisë artistike dhe tarifën e shpërblimit për çdo kategori arti.

Në fund të vitit 2009 në mënyrë të pakuptueshme me propozim të Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendim, Këshilli i Ministrave miraton VKM nr. 1173, datë 6.11.2009 *“Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarure”*, ku në pikën 1, të tij cilësohet se ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike e të veprimtarive të lidhura me to dhe në pikën 11, shfuqizon VKM nr. 309, datë 21.06.1993, **por pa shprehur asnjë fjalë për kriteret e vlerësimit të cilësisë artistike dhe as për masën e shpërblimit të gjinive artistike**, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projekte artistike.

Qeveria kishte detyrimin ligjor për të përcaktuar masën dhe shpërblimin e gjinive artistike, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit pasi në Kreun VIII-të *“Tarifat e shpërblimit të cilësisë Artistike”* neni 34, *“Masa dhe kriteret e shpërblimit”* të ligjit *“Për Artin dhe Kulturën”*, pika 1, përcaktohet se: *“Masa e shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”*, por nuk e bëri, duke i lënë këto institucione në vakum të plotë.

Të ndodhur përpara kësaj situatë disa nga institucionet publike të artit dhe të kulturës dhe veçanërisht bordet artistike, kanë vepruar në mënyrë subjektive për të mos thënë në mënyrë abuzive në vlerësimin e cilësisë artistike të gjinive të ndryshme të artit. Bordet nuk kanë përcaktuar kriteret profesionale të njohura artistike për lloje të ndryshme arti, nuk kanë përcaktuar se si do të bëhet vlerësimi, me sistem pikësh që duhet të ketë në dispozicion çdo anëtar i bordit apo i komisionit të vlerësimit, si do të bëhet votimi i hapur apo i fshehtë etj.

Për të treguar sa thamë më sipër mjafton t’u referohemi konstatimeve të KLSH, në auditimin e kryer në Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, në ish Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve apo së fundmi në Ministrinë e Kulturës ku evidentohet se Bordet Artistike në mbledhjen e tyre të parë nuk kanë përcaktuar kriteret dhe masën e shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet. Përpara marrjes së vendimeve, anëtarët e Bordeve Artistike nuk kanë nënshkruar deklaratën, me anën e së cilës **deklarojnë se nuk kanë konflikt interesi**, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9631, datë 30.10.2006, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*.

Nga auditimet e kryera nga KLSH, për realizimin e **Festivaleve, 47, 48 e 49 e 50 të Këngës për Fëmijë**, rezulton se Bordi Artistik i QKKF, ka parashikuar që shpërblimi për krijimtarinë artistike të jetë rreth 32 % e kostos së festivalit, ndërkohë që shpërblimi i punonjësve të administratës së institucionit me pretendimin se kanë dhënë ndihmesë për rritjen e cilësisë artistike është parashikuar rreth 20% e kostos së festivalit ose sa 63 % e shumës së parashikuar për krijimtarinë artistike. Duke i shqyrtuar këta tregues rezulton se në çdo festival kanë konkurruar 17-20 këngë dhe për një këngë është parashikuar një shpërblim për krijimtarinë artistike rreth 40 000 lekë duke e ndarë këtë shumë për kompozimin, orkestrimin, tekstin etj, kurse shpërblimet e përfituara nga drejtues të administratës së këtij institucioni për çdo festival të zhvilluar janë dy deri tre herë më të mëdha se shumata e përfitur për një këngë nga krijuesit. Dhënia e këtyre shpërblimeve në të njëjtën vlerë me parashikimin e bërë gjatë hartimit të kostos, pa bërë asnjë diferencim në raport me paraqitjen e tyre para publikut tregon për formalizmin e treguar në dhënien e shpërblimeve për fushat e veçanta të artit. Po kështu shfuqizimi i VKM nr 309, datë 21.06.1993, me VKM nr. 1173, datë 06.11.2009, ka bërë që çdo tarifë e aplikuar për vlerësimin e cilësisë artistike, pa vendim të Këshillit të Ministrave, të jetë e pa ligjshme.

Për përmirësimin e gjendjes dhe për t'i prerë rrugë formalizmit, subjektivizmin dhe abuzimit me vlerësimin e cilësisë artistike, KLSH ka rekomanduar, që Institucionet e Artit dhe Kulturës në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Artin dhe Kulturën, të kërkojë nga Këshilli i Ministrave përmirësimin e VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 dhe përcaktimin e kriterëve dhe tarifave të veçanta, për vlerësimin e cilësisë artistike, pagesat për artistët, skenografët, për krijimtaritë e artit skenik, artit muzikor, artit kinematografik, të interpretimit dhe ekzekutimit, publicistikës, si dhe për interpretët e gjinive të ndryshme muzikës live ashtu edhe për "playback".

Unë mendoj se vendosja e disa treguesve të matshëm artistik sipas gjinive të artit, si numri i shfaqjeve pas shfaqjes së parë, preferenca e publikut për veprën artistike, shikueshmëria për çdo shfaqje të dhënë, kërkesat e tregut për veprën artistike apo tregues të tjerë që duhet ti përcaktojnë artistët profesionistë dhe mënyra e vlerësimit të këtyre treguesve me pikë për çdo vepër artistike do të zgjidhte subjektivizmin që kanë shfaqur deri tani Bordet artistike të këtyre institucioneve. Këto institucione duhet të shfrytëzojnë më së miri praktikat ndërkombëtare në këtë fushë që për hir të së vërtetës edhe kur e kanë përfitur si rezultat i bashkëpunimit me homologët e tyre nuk e kanë shfrytëzuar. U përket komunitetit të artistëve sipas

fushave të artit dhe kulturës, të shfaqin mendimet e tyre lidhur me përcaktimin e kritereve që duhen përcaktuar për vlerësimin e cilësisë artistike, pasi është puna dhe djersa e tyre që nëpërkëmbet nga vlerësimet arbitrare të administratës dhe organet e tyre drejtuese.